

Terme të Referencës

Ekspert/kompani për analizë të përputhshmërisë së kuadrit legjislativ me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas sektorëve të synuar

Organizata	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Tituli i angazhimit	Ekspert/ Analiza përputhshmërisë së kuadrit legjislativ me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara sipas sektorëve të synuar
Projekti:	Aleanca në Fushën e Aftësisë së Kufizuara për Reforma Gjithëpërfshirëse në Rajon
Implementuar nga:	ADRF, ANAD, HANDIKOS, Polio Plus
Mbështetur nga:	Ministria Punëve të Jashtme e Norvegjisë
Qëllimi i angazhimit:	Analiza dhe përgatitjen e raportit për pajtueshmërinë e kornizës legjislative dhe Institucionale në sektor, në raport me KNDDPAK;
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë
Data e shpalljes:	7 Prill 2023
Data e mbylljes:	17 Prill 2023
Data e pritshme e fillimit:	25 Prill 2023
Personi/at kontaktues:	handikos@handi-kos.org
Aplikuesit	Persona fizik/persona juridik

1. Prapavija

Në kuadër të projektit rajonal, “Aleanca në Fushën e Aftësisë së Kufizuara për Reforma Gjithëpërfshirëse në Rajon”/“Disability Alliances for Development of Inclusive Reforms in the Region”(DADIRR), që zbatohet në kuadrin e programit rajonal SMART Balkans, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, do të mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për PAK si përfitues përfundimtarë si dhe grupi i synuar i projektit në 3 shtete të projektit (Shqipëri, Kosovë dhe R.N. Maqedoni) përmes garantimit të këtyre të drejtave në harmoni me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KNDDPAK).

2. Objektiva e angazhimit

Objektiva e përgjithshme e ekspertit do jetë përgatitja për shpërndarje dhe publikim të raportit për pajtueshmërinë e kornizës legjislative dhe Institucionale të Kosovës, në raport me KNDPAK, deri me datë 31 Gusht.

Një raport gjithëpërfshirës i pajtueshmërisë legjislative i përgatitur në 3 vende të projektit me pjesëmarrje dhe kontribut nga të gjitha anëtarët e organizatave të personave me aftësi të kufizuara, për Kosovë në këtë rast.

3. Fushëveprimi

Analiza do të tërheqë vëmendje të veçantë në përputhjen e legjislacionit me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

- Analiza e përputhshmërisë së kuadrit legjislativ me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Pasqyrë të përputhshmërisë së legjislacionit me rekomandimet e Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Përcaktimin e rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit në fushat e synuara në nivel kombëtar
- Zbatimin e aktiviteteve të projektit në nivel rajonal.

Analiza dhe përgatitjen e raporti për pajtueshmërinë e kornizës legjislative dhe Institucionale në sektor, në raport me KNDPAK do udhëhiqet nga eksperti në koordinim të ngushtë me grupet punuese të sektorëve legjislative të formuara nga koordinatori i projektit dhe stafit të HANDIKOS dhe partnerët e projektit.

Eksperti do jetë përgjegjës për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Udhëheqë punën e grupit punues legjislative sektoriale në analizën e përputhshmërisë së kuadrit legjislativ me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Merr pjesë në takimet me grupet punuese legjislative sektoriale për të mentoruar progresin
- Analizon kornizën ligjore të Kosovës, në sektorët e targetuar sipas KNDPAK
- Përgatit një raport rreth 60 faqesh për Pajtueshmërinë e Kornizës Sektoriale Legjislative dhe Institucionale me KNDPAK, në atë mënyrë që rezultatet e analizës të jenë të krahasueshme sipas sektorëve për konform metodologjisë së përcaktuar nga HANDIKOS.
- Përgatit 10 faqe përmbledhje të raportit në formatin e versionit të lehtë për t'u lexuar/kuptuar dhe prezantuar për lexues edhe i transmetueshëm në audio dhe gjuhën e shenjave.
- Prezanton te gjeturat e raportit sipas kërkesës së porositesit.

4. Metodatat dhe Mjetet

Metodat e mëposhtme mund të përdoren për të kompletuar detyrat e lartpërmendura dhe përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në ToR.

1. Takim koordinues me HANDIKOS dhe partnerët e projektit;
2. Takime me grupet sektoriale legjislative
3. Takime me persona me aftësi të kufizuara
4. Përdorimi i mjeteve të punës bazuar në metodologjinë e kërkuar për mbledhjen e informatave dhe krahasimin.
5. Përdorimin e legjislacionit, hulumtimeve, raporteve në mënyrë fizike dhe në internet
6. Përdorimi i statistikave dhe informatave të publikuara në media.

5. Kualifikimet, përvoja dhe shkathtësitë kyçe

Kandidati duhet të posedojë shkathtësitë dhe kompetencat e mëposhtme:

- Diplomë në Juridik, Marrëdhënie Ndërkombëtare, ose të ngjashme; specializimet janë përparësi
- Përvojë të gjerë pune në bashkëpunim/punë me sektorin e shoqërisë civile, me theks të veçantë për organizatat personave me aftësi të kufizuara, në ngritje të kapaciteteve për fushën e legjislacionit.
- Përvojë në fushën e analizës së legjislacionit dhe aspekteve krahasimore.
- Përvojë e dëshmuar në përgatitjen e raporteve përfshirë raporteve për versionin e lehtë të lexuarit.
- Përvojë të dëshmuar në mentorimin e fokus grupeve dhe drejtimin e diskutimit.
- Përvojë të dëshmuar në angazhime të ngjashme
- Shkathtësi të mira analitike dhe të dokumentimit/raportimit
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe facilitimit
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të folurit dhe shkrimit në gjuhën Shqipe dhe Angleze
- Ndjeshmëri kulturore ndaj aftësisë së kufizuar.
- Njohuri të mira për aspektet dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara.

6. Kohëzgjatja e angazhimit

Kohëzgjatja e angazhimit llogaritet të jetë 20 ditë. Angazhimi pritet të realizohet gjatë periudhës duke filluar nga 20 Prill 2023 e deri me 30 Shtator 2023 (bazuar në marrëveshjen e përbashkët për datën specifike).

7. Produktet kryesore:

Eksperti do të punojë ngushtë me grupet punuese sektoriale legjislative të formuara për qëllim të projektit dhe ekipin e projektit të HANDIKOS. Të gjitha produktet do t'i dorëzohen ekipit të projektit në datën e caktuar gjatë takimit koordinues. Raportet do të shqyrtohen nga HANDIKOS, grupet punuese,

personat me aftësi të kufizuar dhe partnerët e projektit. Të gjitha draft-dokumentet do të dorëzohen në formë elektronike dhe fizike nëse është e nevojshme ndërsa produktet përfundimtare do të dorëzohen në formë elektronike dhe në kopje të printuara.

Eksperti duhet të dorëzojë produktet e mëposhtme:

- Analizën e përputhshmërisë së kuadrit legjislativ me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara sipas sektorëve të synuar
- Raportin përfundimtarë të analizës së përputhshmërisë
- Përmbledhjen ekzekutive me se shumti ne 10 faqe, ne versionin easy read (lexim i lehte)
- Planin e detajuar për mentorimin dhe drejtimin e grupeve punuese sektoriale.
- Prezantimi në PowerPoint të të gjeturave të raportit
- Materialet dhe referencat të cilat do të përdoren për qëllime të analizës
- Plani e detajuar të analizës së kuadrit legjislativ në fushat e caktuara

8. Buxheti për angazhimin

Buxheti i tërësishëm për angazhimin e ekspertit është 150.00 Euro për ditë, apo 3000.00 euro total për 20 ditë pune. Nuk kompensohen kosto tjera.

Pagesa do realizohet pas aprovimit të raportit të trajnimit dhe dorëzimit të faturës. Faturat duhet të kenë të përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

9. Datat tentativë dhe vendi

Datat për dorëzim të raportit 15 Gusht 2023:

Data për aprovim 15 Shtator 2023.

10. Procedurat për aplikim

Kandidatët e interesuar (personat fizik) apo personat juridik duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme deri më 17 Prill **2023**, ora 16:00.

- CV-në e përditësuar/ CV-te nëse me shume se një person merre pjese ne analize (maksimum 3 faqe);
- Certifikatën e regjistrimit për personat juridik;
- Një draft plan lidhur me metodologjinë e punës për mbledhje informatave dhe analizën krahasimore;
- Një mostër nga puna e tyre e mëparshme në fushën e kërkuar.
- Deklaratën e nënshkruar lidhur me pranueshmërinë e ofertës, që gjendet në fund të kësaj thirrje

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në email adresën: handikos@handi-kos.org me subjektin APLIKIM PËR EKSPERT/ Analizën e përputhshmërisë së kuadrit legjislativ.

Vetëm ofertuesit e listës së ngushtë do të kontaktohen.

PRANUESHMËRIA E OFERTËS –Deklarata

Ofertuesit duhet të nënshkruajnë se nuk janë apo kanë qene subjekt i:

1. janë të falimentuar ose të mbyllur apo punët e tyre administrohen nga gjykatat,
2. kanë qenë ata ose personat që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrëse ose kontrolli mbi to të dënuar për një vepër penale në lidhje me sjelljen e tyre profesionale me aktgjykim të formës së prerë;
3. ata/ato kanë qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale; vërtetuar me çdo mjet që partneri bashkëpunues mund të justifikojë;
4. nuk kanë përmbushur detyrimet në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose të taksave në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar ose me ato të vendit të partnerit bashkëpunues ose të vendit ku do të jetë kontrata e kryera;
5. ata/ato ose personat që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrëse ose kontrolli mbi to kanë qenë të dënuar për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale ose pastrim parash me ane të një aktgjykimi përfundimtar;
6. Ata/ato përdorin punën e fëmijëve ose punën e detyruar dhe/ose praktikojnë diskriminim dhe/ose nuk respektojnë të drejta për lirinë e organizimit dhe e drejta për t'u organizuar dhe për t'u angazhuar në negociata kolektive në përputhje me konventat thelbësore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Personi fizik/ Personi juridik-përfaqësuesi i autorizuar
